

Shpjegim i "Libri i teuhidit" – 9

(E drejta e Allahut ndaj njerëzve)

Mësimet të mbajtura nga dijetari i njohur Salih Ibn Abdul Aziz Muhamed Ali Shejh

(Allahu e faltë atë, prindërit e tij dhe të gjithë muslimanët!)

Përkthyes: Bilbil Talla

Redaktor: Ilir Haxhiaj

Kapitulli: Çfarë është përcjellë në lidhje me rukjet dhe hajmalitë

Në një hadith të saktë, Ebu Beshir el Ensari¹ përcjell se ai ishte duke udhëtuar me Profetin (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Gjatë udhëtimit, ai dërgoi dikë të thërriste ndër njerëz:

"Mos lini asnjë gushore gjalmë apo gushore (qafore) të çfarëdoshme në qafat e deveve pa e prerë!"²

Përcillet se Ibn Mes'udi ka thënë: "E dëgjova të Dërguarin e Allahut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) duke thënë:

"Me të vërtetë, rukjet, hajmalitë dhe *tive/e-t* (lloj magjie për afrimin mes bashkëshortëve) janë shirk" (Ebu Daudi, Ahmedi)³.

Përcillet nga Abdullah Ibn Ukejmi,⁴ i cili përcjell nga Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) se:

"Kush mbështetet në diçka, lihet në dorën e saj."⁵

Imam Ahmedi tregon se Ruvejfi⁶ ka rrëfyer që i Dërguari i Allahut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) i ka thënë:

¹ Ai është Ebu Beshir el Ensari el Seadi. Thuhet se emri i tij është Kajs Ibn Ubejd. Asnjë sahab tjetër nuk mban emrin e tij. Jetoj gjatë dhe vdiq në vitin 63h. Shih: "*Tehdhib el Kemal*: 33/79 dhe "*El Isabe*: 7/41.

² Shënon Buhariu: 3005, Muslimi: 2115.

³ Shënon Imam Ahmedi: 1/381, nr; 3615. Ibn Hibani: 13/456, nr: 6090. Ibn Maxheh: 3530.

⁴ Ai është Abdullah Ibn Ukejmi el Xuheni el Muabbed el Kufij. U bë musliman në kohën e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Thuhet edhe se ishte sahab i tij. Është falur pas Ebu Bekrit (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Vdiq në vitin 88h. Shih: "*Sejr Ealam el Nubela*": 3/510 dhe "*Tehdhib el Kemal*: 15/317.

⁵ Shënon Imam Ahmedi: 4/310, nr; 18781, Tirmidhiu: 2082, El Hakim: 4/2016 dhe El Taberani fji "*El Kebir*" 22/385, nr. 960.

⁶ Ai është: Ruuejfi Ibn Thabit el Ensari el Medeni, sahab i Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Udhëtoi në Egjipt, mori pjesë çlirimet e vendeve afrikane, u bë mäkëmbës i Barkas [në pjesën lindore të Libisë së sotme – (Shënim i përkthyesit)]. Aty edhe vdiq në vitin 56h. Shih: "*Sejr Ealam el Nubela*", 3/510; "*El Bidaje ue El Nuhaje*", 8/61.

"O Ruvejfi, ti ndoshta do të jetosh gjatë. Lajmëroji njerëzit se, kush lidh mjekrën ose vendos varëse (për t'u mbrojtur nga syri) ose pastrohet me bajgat e bagëtime ose me kocka, se Muhamedi është i distancuar prej tij."⁷

Nga Sejid Ibn Xhubejri përcillet se ka thënë: "Kush ia heq hajmalinë një njeriu, është sikur ka liruar një skllav".⁸ [Uekiu]⁹.

Uekiu, gjithashtu përcjell se Ibrahim¹⁰ ka thënë se, ata (shokët e Ibn Mes'udit¹¹) i urrenin të gjitha hajmalitë, me pjesë prej Kuranit ose jo.¹²

Dobitë e temës

- Shpjegimi i "Rukjes" dhe "Temaim"
- Shpjegimi i "Tivale"
- Të tria të mësipërmet, pa përjashtim, janë shirk.
- "Rukja" me fjalët e të vërtetës, nuk është pjesë e shirkut.
- Nëse hajmalitë janë të përbëra me ajete kuranore, dijetarët e diskutojnë nëse janë apo jo shirk.
- Lidhja e varësive në kafshë, me qëllimin e ruajtjes nga mësyshi, është formë e shirkut.
- Qortimi i rëndë ndaj atij që u lidh të tilla gjëra kafshëve.
- Vlera e largimit të hajmalive.
- Fjalët e Ibrahimit nuk bien në kundërshtim me sa u tha deri më tani, pasi ai kishte parasysh shokët e Ibn Mes'udit.

Në temën e mëparshme, autori shkruante: "Vepra shirku, varja e rrethit dhe lidhja e perit". Ndërsa këtu thotë: "Çfarë është përcjellë rreth rukjeve dhe hajmalive". Pra, nuk thotë: Kapitulli i shirkut: "Varja e rrethit dhe lidhja e perit". Përse nuk e tha një gjë të tillë? Sepse nuk janë të gjitha rukjet e ndaluara, d.m.th. ka rukje që janë të lejuara dhe ka që janë të ndaluara dhe shirk. Po ashtu, ka hajmali rreth të cilave të gjithë dijetarët janë në ujdi që janë shirk, por ka edhe nga ato që ka

⁷ Shënon Imam Ahmedi: 4/108, nr.: 16995, Ebu Daûdi: 36, Nesaiu: 5067.

⁸ "Musanna" i Ebu Shejbes: 5/36, nr.: 23473.

⁹ Ai është Ueki Ibn el Xherrah Ebu Sufjan el Ruasij. Prijës në dituri, hafiz, i njohur për agjërim dhe namaz. Lindi në vitin 129h. Jahja Ibn Meini ka thënë: "Nuk kam takuar kurrë me të ditur se Uekiu në kohën e tij". Vdiq në vitin 197. Shih: "Tabekat el Hanabele" i Ibn Ebu Jeala: 1/391 dhe: "Tehdhib el Kemal": 30/462.

¹⁰ Ai është Ibrahim Ibn Jezid Ebu Imran el Neh'ij el Kufij; jurist. Ishte njeri i devotshëm, i mirë dhe prijës në dituri. Mësoi nga Ibn Mes'udi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) . Vdiq në vitin 96h. shih: "El Kesh-shaf": 1/227 dhe: "El Thikat" i Ibn Hibanit: 4/8.

¹¹ Shënim i përkthyesit.

¹² "Musanna" i Ebu Shejbes: 5/36, nr.: 23467 dhe Ebu Ubejdi në: "Fedail el Kur'an": 2/272.

mendime të ndryshme dijetarësh a janë shirk a jo. Prandaj autori këtu thotë “Çfarë është përcjellë rreth rukjeve dhe hajmalive.” Kjo tregon një stil të lartë të autorit.

"*El Ruka*" është shumësi i "rukje". Rukja është diçka e njohur nga arabët, që e përdornin atë. Ajo është e përbërë nga lutje dhe fjalë që thuhet e lexohen, pastaj fryhen në të. Disa nga rukjet ndikojnë tek gjymtyrët e njeriut, të tjera në shpirtin e tij. Disa rukje janë të lejuara fetarisht dhe disa të ndaluara dhe shirk.

Është vërtetuar se Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) i ka bërë rukje vetes¹³ dhe të tjerëve¹⁴. Gjithashtu, është vërtetuar që Xhibrili¹⁵ i ka bërë rukje Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Edhe Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i ka bërë rukje Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).¹⁶ Për këtë arsye, autori sqaron se cili është gjykimi islam për rukjet, pra, kur janë të lejuara dhe kur janë të ndaluara. Sheriati e ka lejuar për lehtësim atë lloj rukje që nuk përbën shirk. Pra, nëse rukja nuk përbën shirk, atëherë ajo është e lejuar.

Disa sahabë e pyetën Profetin (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) rreth gjykimit të rukjes dhe Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) u tha:

“M’i sillni t’i shoh rukjet!”. Pastaj tha: “Nuk ka asgjë të keqe të bësh rukje që nuk përmbajnë shirk.”¹⁷

Dijetarët kanë thënë që rukja është e lejuar, nëse plotësohen tri kushte:

I pari: Rukja të bëhet me Kuran, apo me emrave të Allahut a Cilësive të Tij-Madhëruar qoftë!

I dyti: Rukja të bëhet në gjuhën arabe dhe me gjuhë të qartë e të kuptueshme.

I treti: Ai të cilit i bëhet rukja të mos besojë se rukja ndikon vetvetiu, por me caktimin e Allahut të Madhërishëm.

¹³ Shënon Buhariu: 4439; Muslimi: 51/2192. Transmetimi prej Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) është i Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!), e cila thotë se Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) kur ankohej nga diçka, këndonte suret "mbrojtëse" dhe i frynte vendit ku ndjente dhimbje.

¹⁴ Në një formë tjetër transmetimi të të njëjtit hadith thuhet se: Kur Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) i sëmurëj një pjesëtar i familjes, i frynte vendit të sëmurë, pasi kishte kënduar "suret mbrojtëse".

¹⁵ Sikurse shënon Muslimi: 2186.

¹⁶ Sikurse shënon Buhariu: 5735, dhe Muslimi: 2192.

¹⁷ Shënon Muslimi: 2200. Sahabi që e sjell hadithin është Auf Ibn Malik el Eshxhej (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

Kurse disa dijetarë në kushtin e parë vendosin edhe që forma e rukjes të jetë verifikuar që e ka bërë Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Nisur nga kjo, kushti i parë është: që lutja të bëhet me Kuran, me Sunet (lutje dhe dhikër që ka bërë Profeti -Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ose me emrat dhe cilësitë e Allahut.

Kështu, rukja është e lejuar vetëm nëse plotëson këto tri kushte. Megjithatë, dijetarët nuk janë të një mendimi nëse rukja është e lejueshme kur nuk plotësohet kushti i parë dhe i dytë. Sa i përket kushtit të tretë, të gjithë dijetarët janë në unanim që duhet të përmbushet. Ndërsa dy kushtet e para, që: rukja të bëhet me emrat dhe cilësitë e Allahut, me Kuran dhe Sunet dhe që duhet të jetë në gjuhë të kuptueshme arabe, ka mosdakordësi mes dijetarëve, sikurse u theksua më lart.

Disa thonë që rukja mund të bëhet edhe me fjalë të tjera të kuptueshme, apo në gjuhë tjetër të kuptueshme. Pra, sipas tyre, uk është kusht që të jetë vetëm në gjuhën arabe dhe nuk është kusht, gjithashtu, që të jetë me Kuran dhe Sunet.

Sidoqoftë, këto janë disa çështje që kërkojnë studim të mëtejshëm. Sa i përket a ndikon rukja me diçka tjetër veç Kuranit dhe Sunetit, do të flasim insh-Allah në një vend tjetër. E rëndësishme këtu është që rukja e lejuar me mendim unanim dijetarësh është ajo që i përmbush të tri kushtet e përmendura më lart.

Rukjet e ndaluara dhe rukjet shirk janë ato në të cilat ka kërkim ndihme apo kërkim mbrojtjeje nga dikush tjetër përveç Allahut, apo rukjet në të cilat përmenden emra të shejtanëve, apo ato kur personi që i bëhet rukja beson se ajo ndikon vetvetiu e jo me caktimin e Allahut të Madhëruar. Për këtë lloj, Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë:

“Rukjet, hajmalitë dhe *tivale*-ja janë shirk”.

Si përfundim, ka rukje që janë të lejuara dhe ka që janë të ndaluara dhe me përmbajtje shirku. Kurse për “*temaim*” (hajmalitë) thamë se ato janë të llojeve të ndryshme. Ato janë gjëra që lidhen dhe varen në trupin e njeriut, me qëllimin e arritjes së ndonjë mirësie apo largimin e ndonjë të keqeje, duke menduar se ato janë shkaqe ndikuuese, por e vërteta është se Allahu i Madhërishëm nuk i ka bërë të tilla as me fe (Kuran dhe Sunet) dhe as me caktimin e Tij, pra, nuk e ka caktuar që në praktikë këto hajmali të kenë efekt në pengimin a largimin e një të keqeje apo për arritjen e ndonjë të mire.

Hajmalia është diçka që bëhet me lëkurë, me letër etj., ku shkruhen lutje ose dhikër, e pastaj vendoset atë në gjoks, në krah etj. Nganjëherë, hajmalitë mund

të jenë rruaza, gjalmë e kështu me radhë. Të gjitha këto futen në hadithin e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) për hajmalitë. Edhe ato sende që vendosen në dyert e shtëpisë, në vetura, në dyqane atj., quhen hajmali.

Si përfundim, hajmali quhen të gjitha ato gjëra, përmes të cilave njeriu kërkon t'i realizohet një çështje ose t'i largohet një e keqe ndërsa nuk janë të lejuara nga Sheriati dhe Allahu nuk i ka bërë shkaqe as në caktimin e Tij (edhe në praktikë ato nuk janë të tilla).

Në këtë mënyrë, hajmalia nuk ka një formë të veçantë, por ka shumë lloje të saj. Për shembull, në kohën tonë, ne e shohim se njerëzit përdorin lloje të ndryshme hajmalish, të cilat i vendosin në trup, në gjoks, në qafë, në dorë e kështu me radhë. Disa prej tyre janë nga një lëkurë e caktuar dhe vendosen në qafë, në krah ose në bark, me qëllimin e largimit të sëmundjeve të brendshme, si diarreja, vjellja, etj.

Disa hajmali janë prej kafshësh, si kokë ariu apo lepuri, e disa janë lloje të tjera, si patkoi dhe tespihët, që varen përpara pasqyrës. Disa përdorin si hajmali zinxhirë, të cilëve një sy të vogël, zakonisht me ngjyrë të kaltër. Të tjerë varin në hyrje të shtëpisë një kokë ujku ose kaprolli. Disa vendosin te dera, në vendin ku trokitet, një patkua kali ose mushke. Të gjitha këto i vendosin duke besuar se ato të mbrojnë nga mësyshi apo të sjellin mbarësi. Pra, të gjitha këto gjëra janë forma hajmalish, të shpikura nga njerëzit në kohë të ndryshme.

Ka njerëz që thonë se i vendosin për zbukurimin e shtëpisë, të veturës e të trupit, pa besuar se ato u sjellin mbarësi apo u largojnë të këqijat. Kështu thonë disa njerëz, edhe pse janë të paktë. Ne u themi të tillëve që, nëse i mbani ato sepse besoni që ato janë shkak për mbarësi ose për të larguar të këqijat, atëherë keni bërë shirk të vogël. Por edhe nëse i vendosni ato vetëm për zbukurim, atëherë përsëri është e ndaluar (haram), për arsye të përngjasimit me ata që kanë rënë në shirk të vogël. Kështu çështja e tyre është brenda rrethit të haramit në të gjitha rastet. Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë:

“Ai i cili i përngjason një populli, ai është prej tyre.”¹⁸

¹⁸ Shënon Imam Ahmedi në *Musned*: 2/50, nr; 5114, Ebu Daûdi: 3031, Ibn ebu Shejbeh: 4/212, nr. 19401. Sahabi që tranmeton hadithin është Ibn Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

Pastaj autori sjell një hadith, si argument për këtë temë. Në një hadith të saktë, Ebu Beshir el Ensari tregon se ai ishte duke udhëtuar me Profetin (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Gjatë udhëtimit ai dërgoi dikë të thërriste ndër njerëz:

"Mos lini asnjë gushore gjalmë apo gushore (qafore) të çfarëdoshme në qafat e deveve pa e prerë!"

Hadithi tregon se varëset prej gjalmi të varura te kafshët duhet të hiqen. Arabët në të kaluarën besonin se ato i mbronin devetë nga mësyshi. Kishte raste që në varëse vendosnin edhe rruaza, flokë etj. Ky është një lloj hajmalie.

Përkimi i hadithit me kapitullin është i qartë. Thënia "Mos lini asnjë gushore gjalmë apo gushore të çfarëdoshme në qafat e deveve pa e prerë!", është e qartë që ndalon hajmalitë. Ky hajmali duhet që të hiqet, sepse lidhet me besimin se ajo largon të keqen dhe sjell të mirën, e ky lloj besimi është shirk.

Thënia: Përcillet se Ibn Mes'udi ka thënë: "E dëgjova të Dërguarin e Allahut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) duke thënë: "Vërtet, rukjet, hajmalitë dhe *tivele*-t janë shirk". Hadithi përmban edhe pjesëzën "*Inne*" (Vërtet), e cila në gjuhën arabe përdoret për të vënë theksin mbi diçka. Në një fjali kallëzore, pjesa që vjen pas saj është e theksuar.

"*el ruka*" - Fakti që kjo fjalë paraprihet nga nyja shquese "el" tregon që është gjithëpërfshirëse. Në këtë mënyrë, ky hadith regon se të gjitha llojet e rukjeve janë shirk, të gjitha llojet e hajmalive janë shirk, të gjitha llojet e *tivele*-s janë shirk. Nga të gjitha këto gjëra, hadithet kanë përjashtuar ca rukje, si për shembull hadithi: "Nuk ka të keqe te rukjet, përderisa nuk përmbajnë shirk". Gjithashtu, Profeti vetë u ka bërë rukje të tjerëve, madje vetë atij i është bërë rukje. Kështu, argumentet tregojnë se nga forma përgjithësuese e hadithit ka disa raste të përjashtuara. Jo të gjitha llojet e rukjeve janë shirk. Vetëm disa lloje të tyre janë shirk.

Hadithi vjen edhe në një formë tjetër, ku thuhet:

"Nuk ka të keqe në bërjen e rukjes, nëse nuk është shirk." Ose: "Nuk ka të keqe në bërjen e rukjes, nëse ajo nuk përmban shirk".

Në lidhje me hajmalitë, nuk ka ardhur ndonjë argument që të përjashtojë ndonjë formë të caktuar të tyre. Nisur nga kjo, themi se të gjitha llojet e hajmalive janë shirk. Nëse Ligjvënësi nuk bën përjashtime, atëherë në fuqi mbetet rregulli i

përgjithshëm. Përrjashtimi është e drejtë e Ligjvënësit dhe këtu ai nuk ka përrjashtuar ndonjë formë të caktuar, kështu që rregulli bazë mbetet në fuqi.

- *tivele* – Et-tivele, siç e ka shpjeguar edhe Shejhu, është diçka që përrgatitej nga arabët me besimin se ajo do të afronte bashkëshortët me njëri-tjetrin. Ajo është një lloj magjie. Te njerëzit njihet me emrin "*es sarf*" ose "*el atf*". Ajo është një lloj magjie që bëhet për të sjellë a larguar diçka sipas besimit të tyre. Në realitet, ajo është një lloj nga llojet e hajmalive, pasi ajo përrpunohet nga magjistari, i cili i këndon rukjen me përrmbajtje shirku, duke bërë që gruaja të dojë bashkëshortin e saj apo bashkëshorti gruan e tij. Sikurse thamë, kjo është një lloj magjie, dhe magjitë janë shirk dhe kufër ndaj Allahut të Madhëruar. E hadithi është gjithëpërrfshirës, pra, të gjitha llojet e *tivele*-s janë shirk.

Përrcillet nga Abdullah Ibn Ukejmi, që tregon nga Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) se:

"Kush var diçka, lihet në dorën e saj."

- "*shej'en*" (diçka) është në formën e pashquar kushtore, që nënkupton gjithçka, pa përrjashtim. Çdokush që var diçka për fat, do të lihet në dorën e saj. Këtu, kush kërkon të përrjashtojë ndonjë send të caktuar, duhet të sjellë argument fetar. Argumenti ynë është i përrgjithshëm dhe tregon se kush var diçka, çfarëdo qoftë, braktiset në dorën e saj.

Nëse njeriu lëshohet në dorën e dikujt tjetër përveç Allahut, atëherë atë do ta rrethojë humbja nga të gjitha anët. Krenaria, shpëttimi, sukcesi, qëllimi i mirë, vepra e mirë e njeriut varet vetëm nga lidhja e mirë me Allahun. Shpresën për të ardhmen dhe largimin e të keqes, besimtari e lidh vetëm me Allahun. Zemra e tij gjen prehje vetëm tek Allahu, ajo është e lumtur vetëm me Allahun, çështjet ia lë në dorë Allahut, Atij i mbështetet. Kush vepron në këtë formë, i mbështetet Allahut dhe i largon krijesat nga zemra, sikur qiejt dhe toka t'i ngrinin kurthe, Allahu do t'i japë rrugëdalje, pasi ai është mbështetur te Madhështori i Lartësuar, - iu shenjtërofshin emrat e Tij! Profeti ka thënë:

"Kush var diçka (për fat), lihet në dorën e saj."

Nëse njeriu var një hajmali, lihet në dorën e saj. Atëherë, ç'mendon për dikë që lihet në dorën e një rrecke, e një rruaze, e një patkoi a koke kafshe? S'ka dyshim se humbja e tij është më e madhja.

Aspekti argumentues në hadithin: "Kush var diçka...":

Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) përmend përfundimin e varjes së diçkaje, që është se: kush vepron një gjë të tillë, lihet në dorën e saj. E nëse ai lihet në dorën e saj, do të thotë se e ka humbjen të sigurt. Shejhu nuk përmend se çfarë gjykimi kanë veprat e përmendura në kapitull, kështu që gjykimin e tyre e mësojmë nëpërmjet këtyre haditheve.

Thënia: Hajmalitë janë sende që u varen fëmijëve për ti mbrojtur nga syri. "Shej'un" (diçka, send) - është fjalë përgjithësuese. Ajo përfshin gjithçka që varet, pa veçuar ndonjë formë a send të caktuar. Disa dijetarë kanë veçuar ato që janë të bëra me rruaza, të tjerë ato që janë të bëra prej lëkure e të ngjashme, por këto nuk janë të sakta. 'Hajmali' është emër që përmbledh gjithçka që varet me qëllimin e mbrojtjes nga mësyshi, pengimin e së keqes, apo arritjen e një të mire.

Pastaj thotë: Por nëse ajo gjë e varur është nga Kurani, atëherë një pjesë e të parëve e kanë lejuar. Domethënë: Nëse sendi i varur është prej Kuranit, siç është për shembull mbajtja e Kuranit në shtëpi me qëllim të mbrojtjes nga syri, ose mbajtja e një pjese të tij, si suren Ihlas apo ajetin Kursij. Kjo gjë, në aspektin e varjes, quhet hajmali, por a është e lejuar, apo jo?

Shejhu -Allahu e mëshiroftë! - thotë se, për hajmalitë e përbëra me pjesë Kurani, të parët tanë kanë mendime të ndryshme. Një pjesë e tyre e kanë lejuar. Me fjalën "një pjesë të tyre" nënkuptojmë dijetarët e mëdhenj në mesin e sahabëve. Këtë mendim kanë edhe disa dijetarë të mëdhenj të mëvonshëm. Prej tyre është Ibn Mes'udi dhe shokët e tij, ndër të cilët Ibrahim el Nahi, Alkame¹⁹, Abideh²⁰, Rabia Ibn Huthejmë²¹, El Esuedi etj.²²

Si përfundim, të parët tanë kanë pasur mospajtime në lidhje me këtë çështje, dhe dihet rregullisht që thotë se: Nëse të parët tanë kanë pasur mospajtime në lidhje me një çështje, atëherë detyrimisht duhet që t'i referohemi argumentit fetar. Sakaq,

¹⁹ Alkame Ibn Kajs Ibn Abdullah ebu Shebl el Neh'ij. Ai prej shokëve të mëdhenj të Ibn Mes'udit dhe dijetar i tyre. Ngjante shumë me Ibn Mesudin. Transmetoi hadithe nga një grup sahabësh. Vdiq në luftë në vitin 62h. Shih: "El Bidaje ue El Nihaje": 8/217 dhe "Mearifetu el Kurai el Kibar": 1/51.

²⁰ Abideh el Selmanij, njëri prej imamëve të mëdhenj. Pranoi Islamin sa ishte gjallë Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Transmetoi hadithe nga një grup sahabësh. Ishte i barabartë me Shurejhin në dituri dhe në aktivitetin e gjykimin. Vdiq në vitin 72. Shih: "El Keshaf": 1/694 dhe "Tehdhib el Tehdhib": 7/78.

²¹ Rabia Ibn Hujthejm ebu Jezid el Theurij. Imami shembull, shoku i Ibn Mesudit. Ibn mein thotë: Për të nën pyetet. Ibn Mesudi i tha një ditë: "Po të të shihte Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) do të të donte". Shih: "Tehdhib el Kemal: 9/70, "Tedhkiratu el Hufadh": 1/57.

²² El Esued Ibn Jezid Ibn Kajs ebu Amru el Nehij. Imami shembull, daja i Ibrahim el Nahiut. Jetoj në kohën e xhahilijetit dhe të Islamit. Ai është nga shokët e mëdhenj të Ibn Mesudit. Merret për shembull në adhurim. Ai vdiq në vitin 75h. Shih: "Sejr Ealam el Nubela": 4/53 dhe "Tehdhib el Kemal: 3/233.

argumentet fetare tregojnë se të gjitha llojet e hajmalive janë të ndaluara, sikurse është hadithi i Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): "Kush var diçka lihet në dorën e saj" apo "Rukjet, hajmalitë dhe *tivele*-ja janë shirk." Kështu, kur var Kurani a një pjesë të tij, është brenda ndalimit. Por nëse ajo që varet është tekst Kurani a një pjesë e tij, ajo nuk konsiderohet shirk, pasi Kurani është atribut i Allahut të Lartësuar. Kështu, personi nuk i ka shoqëruar Allahut ndonjë nga krijesat e Tij. Shirk do të thotë që t'i shoqërosh Allahut të Lartësuar një krijesë, ndërsa Kurani nuk është i krijuar. Ai është fjalë e Allahut të Madhërishëm: prej Atij erdhi dhe tek Ai do të kthehet.

Pra, nëse përjashtojmë hajmalinë e përbërë nga Kurani nga të qenit shirk, nisur nga fjala e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): "Vërtet, rukjet, hajmalitë dhe *tivele*-ja janë shirk", një gjë të tillë e bëjmë për faktin se Kurani është fjalë e Allahut dhe nuk është i krijuar. Por, a është e ndaluar që të varet apo nuk është e ndaluar?

Përgjigje: Thënia e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) "Kush var diçka lihet në dorën e saj" dhe ndalimi i të gjitha llojeve të hajmalive është argument se përjashtimi i hajmalive me Kuran kërkon një argument. Kjo, pasi lënia në fuqi e argumentit bazë nënkupton lënien në fuqi të vullnetit të Ligjvënësit të shprehur me fjalë. Veçimi i një rregulli duhet patjetër që të shoqërohet me argument të qartë. Ndaj dhe argumenti fetar flet për ata që nuk e lejojnë një gjë të tillë, siç është Ibn Mesudi dhe shokët e tjerë të Profetit (Allahu qoftë i kënaqur me ata!). Ky është edhe mendimi i pjesës më të madhe të dijetarëve, është njëri nga mendimet që vjen prej imam Ahmedit dhe është ai i përzgjedhuri nga nxënësit e tij. Ky është edhe mendimi përfundimtar i shkollës tek të mëvonshmit. Mbetet të themi se, lejimi i hajmalive me përmbajtje Kurani sjell disa gjëra negative si:

* Së pari, shpie në dyshime. Sheh dikë që mban hajmali dhe nuk je i qartë a është ajo me përmbajtje Kurani apo jo? Nëse kjo mundësi ekziston, atëherë veprimi për të reaguar ndaj diçkaje që përmban shirk do të ishte i dobët, sepse është dyshimi që hajmalia të jetë me përmbajtje Kurani. Nëse do ta lejonim, nuk do të kishte reagim ndaj hajmalive me shirk, pasi në shumicën e rasteve hajmalitë nuk janë të dukshme, sepse janë të mbështjella me lëkurë ose rrobë. Nëse do ta pyesësh personin që mban një hajmali se a është e përbërë ajo me Kuran apo është me shirk, dihet se ai që bën një veprim të papranueshëm do të përgjigjet se është me Kuran, në mënyrë që të shpëtojë veten. Kështu, prej dëmeve të mëdha, në rast se ne do të lejonim mbajtjen e hajmalive të përbëra me Kuran, do të ishte heqja dorë nga kundërshtimi i hajmalive me përmbajtje

shirku. Duke ndaluar të gjitha llojet, i kemi mbyllur derën hajmalive me përmbajtje shirku. Edhe sikur të mos kishte arsye tjetër, vetëm kjo do të mjaftonte.

* Pjesa e paditur e njerëzve, po të mbajnë një hajmali me Kuran, zemrat e tyre lidhen pas saj, kështu për ata hajmalia nuk do të ishte thjesht një sebep, por ata do të besonin se ndikon në mënyrë të pavarur, që ndalon të keqen dhe sjell të mirën. Nuk ka dyshim se kjo do të nënkuptonte hapjen e dyerve për besëtytnitë e dëmshme, në vend që të bëhej e kundërta. Ndërkaq është e ditur se metodologjia e Sheriatit është mbyllja e derës për pasojat negative.

* Prej gjërave negative të pashmangshme, gjithashtu, është se hajmalitë me përmbajtje kuranore do të nënçmoheshin, pasi njerëzit mund të flenë mbi to, mund të futen në vende të papastra, ose mund të gjenden në situata të papërshtatshme, duke patur Kuranin me vete. Kjo gjë duhet të shmanget. Si përfundim, si me argument fetar, por edhe me logjikë, rezulton se: hajmalitë e të gjitha llojeve nuk janë të lejueshme. Nëse ato janë me përmbajtje kuranore, themi se mbajtja e tyre është haram, sipas mendimit më të saktë, prandaj duhet që të kemi një reagim të caktuar ndaj atyre që e mbajnë atë. Nga ana tjetër, nëse janë jo me përmbajtje Kurani, themi që atoj anë shirk ndaj Allahut të Lartësuar, pasi Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: "Vërtet, rukjet, hajmalitë dhe *tivele*-la janë shirk." Përrjashtimi nga ky rregull i përgjithshëm duhet të bëhet me argument të veçantë fetar.

Në fund të këtij kapitulli mbetet të shtjellojmë hadithin e sjellë nga imam Ahmedi. Imam Ahmedi tregon se Ruvejfi²³ ka rrëfyer që i Dërguari i Allahut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) i ka thënë:

"O Ruvejfi, ti ndoshta do të jetosh gjatë. Lajmëroji njerëzit se, kush lidh mjekrën ose vendos varëse (për t'u mbrojtur nga syri) ose pastrohet me bajgat e bagëtive ose me kocka, se Muhamedi është i distancuar prej tij."²⁴

Hadithi është përmendur edhe në kapitullin: "Transmetimet në lidhje me rukjet dhe hajmalitë". Aty përmendet varja e hajmalive në qafë dhe se Muhamedi (paqja e Allahut qoftë mbi të!) distancohej nga ata që e bënë një gjë të tillë. Po ashtu, në fillim të kapitullit është përmendur hadithi i saktë nga Ebu Beshir el Ensari, se Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), gjatë një udhëtimi, dërgoi dikë

²³ Ai është: Ruuejfi Ibn Thabit el Ensari el Medeni, sahab i Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Udhëtoi në Egjipt, mori pjesë çlirimet e vendeve afrikane, u bë mëkëmbës i Barkas [në pjesën lindore të Libisë së sotme – (Shënim i përkthyesit)]. Aty edhe vdiq në vitin 56h. Shih: "Sejr Ealam el Nubela", 3/510; "El Bidaje ue El Nuhaje", 8/61.

²⁴ Shënon Imam Ahmedi: 4/108, nr; 16995, Ebu Daûdi: 36, Nesaiu: 5067.

të thërriste ndër njerëz: "Mos lini asnjë gushore gjalmë apo gushore të çfarëdoshme në qafat e deveve pa e prerë!"²⁵ Edhe hadithi tjetër është i ngjashëm me këtë.

Thënia e autorit: Në këtë hadith thuhet "ose vendos "veter" (gjalmë)" – Nga gjërat e varura këtu veçohen ato që janë "veter". Kjo e ka një kuptim, që do të thotë se ndalimi nuk përfshin të gjitha llojet e varësive, por bën fjalë për ato varëse që vendosen me qëllimin e largimit të mësyshit. Ai përmend vetëm gjalmin, pasi njerëzit e kohës parai-slame e lidhnin atë bashkë me leckë, flokë, a kockë, me qëllim që të largonin mësyshin nga devetë. Ndërsa po të varësh thjesht diçka, po qëllim, tradita profetike tregon se është e lejuar.

Kështu mund të themi: Varëset që u vendosen kafshëve apo që vendosen në vende të tjera nëse me to lidhet ndonjë lloj besimi, apo janë tradite besimore e një populli të caktuar janë të ndaluara. Ndaj edhe që në fillim hadithi bën dallimin duke thënë: "Mos lini asnjë gushore gjalmë (veter) apo gushore të çfarëdoshme në qafat e deveve pa prerë." Parafjala "min" është në rolin e sqarueses. Po ashtu në këtë hadith tha: "Ose vendos veter". Kuptimi është i qartë, se veteri dhe hajmalia kanë gjykim të njëjtë.

Thënia: "Se Muhamedi është i distancuar prej tij". Këto janë nga ato lloj shprehjesh që tregojnë se, kush bën një vepër të tillë, ka bërë një nga gjynahet e mëdha. Pasi për të treguar se një veprim i caktuar është prej gjynaheve të mëdha përdoret shprehja: "Allahu dhe dërguari i Tij distancohen nga filan njeri", apo se Profeti është i distancuar prej tij. Kjo tregon sa i llahtarshëm është një gjynah. Shirku i vogël është prej gjynaheve të mëdha, sikurse edhe shirku i madh. Një gjynah i madh është i tillë kur personi nuk e mendon të lejuar një vepër të caktuar, siç është imoraliteti, vjedhja, pirja e alkoolit, për nga lloji i ndalimeve ato janë gjynahe të mëdha, në gradë më të ulët se shirku i vogël, e aq më shumë nga shirku i madh. Prandaj themi: Lloji i shirkut të vogël; si varja e hajmalive, etj. është gjynah më i madh se lloji i veprave që konsiderohen gjynahe të mëdha, në rast se personi nuk mendon se veprimi i një gjynahu të madh; imoraliteti, vjedhja, pirja e alkoolit e të ngjashme është i lejuar.

Thënia e autorit: Transmetohet se Seid Ibn Xhubejri ka thënë: "Kush ia heq hajmalinë një personi, është si të liroi një rob." Ky transmetim na tregon për vlerën e heqjes së hajmalive, kjo pasi mbajtja e tyre është shirk ndaj Allahut të

²⁵ Transmeton Buhariu: 3005, Muslimi: 2115.

Lartësuar, sakaq shirku i vogël shpie në Zjarr, ai që bën shirk të vogël është i paralajmëruar me Zjarr. Allahu i Madhërishëm thotë:

"Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij"²⁶

Profeti (paqja e Allahut qoftë mbi të!) thotë:

"Kush vdes dhe lut dikë tjetër si të barabartë me Allahun, do të hyjë në Zjarr"²⁷

Ngjashëm me këtë ai thotë:

"Kush vdes duke i bërë shirk Allahut, do të hyjë në Zjarr"²⁸

Kështu kush ia heq hajmalinë dikujt është sikur ta ketë liruuar atë që ia hoqi hajmalinë nga Zjarri, ngaqë ka bërë një vepër të ngjashme me atë që liron një rob nga robëria. Në momentin që ia heq hajmalinë do të marrë shpërblimin të njëjtë me veprën. Sikurse ai e shpëtoi një musliman nga Zjarri, do të shpërblehet barabartë me atë që liron një rob. Kjo thënie e Seid Ibn Xhubejrit nënkupton se diçka të tillë ai e ka dëgjuar nga ndonjëri prej shokëve të Profetit (paqja e Allahut qoftë mbi të!) sepse kjo nuk mund të thuhet me mendje. E nëse është kështu, ky hadith konsiderohet "mursel". Për sa kohë në hadith tregohet vlera që ka heqja e një varëseje nga qafa e dikujt, hadithi është i llojit "*mursel*" që u përmend. *Mursel* do të thotë se hadithi bën pjesë në llojet "*merfuë*". Seid Ibn Xhubejri është *tabiîn* (brezi që pason brezin e shokëve të Profetit). Ai ishte prej shokëve të Ibn Abbasit.

Në lidhje me argumentimin me një hadith "mursel", dijetarët kanë mendime të ndryshme. Imam Ahmedi, Maliku dhe Ebu Hanifja e konsiderojnë argument. Ndërsa të tjerë argumentojnë me të, në rast se domethënia e hadithit është e njohur, siç është në rastin tonë.

Ndërkaq, disa të tjerë mendojnë se thënia e një tabiîni në gjëra që nuk mund të përftohen duke hulumtuar dhe nuk mund të arrihen me mendje, konsiderohet si thënie e një shoku të Profetit (paqja e Allahut qoftë mbi të!), pra që një thënie të tillë tabi'ini e ka dëgjuar nga një shok i Profetit (paqja e Allahut qoftë mbi të!). Në këtë rast ajo konsiderohet si hulumtim i një shoku të Profetit (paqja e Allahut qoftë mbi të!). Por ky mendim nuk është i qëndrueshëm. Kjo pasi nëse themi që

²⁶ EN-NISÂ': 48.

²⁷ Buhariu: 4497 (fjalët e hadithit janë të tij), Muslimi: 92, hadithi i Ibën Mesudit (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

²⁸ Buhariu: 1238, Muslimi: 92, hadithi i Ibën Mesudit (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

një thënie të tillë tabi'ini e ka dëgjuar nga një shok i Profetit (paqja e Allahut qoftë mbi të!) mund të themi gjithashtu se ai një thënie të tillë nuk mund ta thotë nga mendja e tij, patjetër që ai e ka dëgjuar nga vetë Profeti (paqja e Allahut qoftë mbi të!) sepse në thënie të tilla mendja nuk ka rol. Mendimi i parë është më i përhapuri, se kjo formë është nga lloji i hadithit "mursel".

Thënia e autorit: "Uekiu, gjithashtu, përcjell se Ibrahim...". Është fjala për Ibrahim el Nahi, nxënës i Ibn Mesudit. Ai ishte më i dituri i qytetit të Kufes, pas Ibn Mesudit. "Ibrahimi ka thënë: "Shokët e Ibën Mesudit i urrenin të gjitha hajmalitë, me pjesë Kurani ose jo". Ndër shokë të Ibn Mesudit ishin El Esued, Alkameh, Rabi Ibn Hajthem, Abidete el Selmani, etj.